

Këshilltari për shtyp në zyrën e Hatajit për punimet në Siri të Fondacionit humanitar IHH Burak Karaxhaoglu (Burak Karacaoğlu) ka bërë thirrje për ndihma emergjente në Siri, raporton Anadolu Agency (AA).

Karaxhaoglu tha për gazetarin e AA se: “Vendi me 20 milionë banorë ka nevojë për ndihma emergjente humanitare për afërsisht 10 milionë banorë”.

Karaxhaoglu thekson se në këtë proces 6.5 milionë sirianë u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre dhe 3 milionë prej tyre gjetën shpëtim duke ikur në vendet fqinje. Sirianët të cilët u detyruan të largohen nga vendi, tre të katërtat e tyre e përbëjnë gratë dhe fëmijët, mbi 1 milionë fëmijë mundohen të vazhdojnë jetën e tyre në kushte të vështira larg vendit dhe shtëpive të tyre.

Karaxhaoglu duke tërhequr vëmendjen për rritjen e problemeve nga përkeqësimi i motit të ftohtë tha se: "Populli sirian i goditur nga lufta dhe varfëria është i detyruar të luftojnë edhe kundër motit të ftohtë. Për arsye të rritjes së numrit të refugjatëve dita ditës edhe nevojat e tjera janë bërë të pa-përballueshme. Ndihamat më në nevojë janë furnizimet ushqimore si miell, sheqer, oriz dhe vaj.”